

CH-Kosovë

Ndihma zvicerane për komunat në Kosovë

HELVETAS Swiss Inetrcooperation ka pajisur pesë komuna të Kosovës lindore me “One stop shops” dhe ka bërë edhe trajnime për të punësuarit



Hani i Elezit hap një zyrë të re, moderne të komunës ndërsa në Kaçanik është rinovuar një shkollë fillore. Këto janë dy nga projektet e shumta, të cilat Zvicra, gjegjësisht Drejtoria për Zhvillim dhe Bashkëpunim (DEZA) i ka financuar në Kosovë.

Organizata zbatuese me këtë rast është HELVETAS Swiss Intercooperation. Një hedhje syri në vendin e ngjarjes tregon se sa e nevojshme vazhdon të jetë ndihma për komunat në shtetin e ri.

Në Han të Elezit ne shohim një zyrë komune të porsahapur, e cila është vendosur në një ndërtesë të vogël të komunës, të financuar nga USAID-i. I gjithë enterieri, përfshirë edhe kompjuterët është financuar nga LOGOS, siç quhet Programi i Helvetas Swiss Intercooperation për Autoritetet Lokale dhe për Decentralizimin.

Në ambientin e ndritshëm rrinë ulur pranë kompjuterëve të tyre dy nëpunës administrativë mbrapa sporteleve prej qelqi. Sapo vjen një klient dhe paraqitet në sportelin e parë, ku, për të kryer punën e tij e udhëzojnë për në sportelin e pestë.

Në sportele qëndrojnë mbishkrimet si “Regjistri civil”, “Tatimet dhe taksat” dhe “Adminstrata”. Klienti lëshon zyrën pas pak minutave i kënaqur dhe i befasuar me faktin se sa shpejt e ka mbaruar procedurën e nxjerrjes së pasaportës të birin dhe veç kësaj, këtu sipas tij është shumë më bukur dhe më këndshëm se sa në zyrën e vjetër.

I hedhim një sy lokalit të vjetër: ai është i vogël, i zyrtë, me vetëm dy sportele, para të cilëve ndodhte shpesh që njerëzit të shtyheshin. Këtu mund të zgjidhej vetëm një pjesë e kërkesave, shpesh njerëzit udhëzoheshin për në zyrat tjera të ndërtesës së komunës. Zyra e tashme i plotëson standardet evropiane, qytetarët, me këtë “One stop shop” kanë tashme një qendër të vetme kontakti për preokupimet e tyre.

Prej aty, kërkesat e tyre dërgohen në mënyrë elektronike në pikat përgjegjëse administrative ndërsa përgjigja ose dokumenti përkatës vijnë sërish në zyrë. Sipas ligjit, një procedurë mund të zgjasë më së shumti 30 ditë por numri më i madh i kërkesave mund të zgjidhen brenda një dite.

Me këto “One stop shops”, me një kosto relativisht të ulët financiare mund të realizohet shumë për popullatën, konstaton Merita Barileva, përgjegjëse e programeve nga LOGOS. Njerëzit, sipas saj në sistemin e vjetër kanë humbur shumë kohë për të nxjerrë, fjala vjen një certifikatë lindjeje ose martese, për të paguar tatimet ose për të sqaruar një çështje pronësie.

Duke qenë se nëpunësit kompetentë punonin nëpër zyra të ndryshme, nganjëherë edhe në ndërtesa të ndryshme, qytetarët barteshin shpesh nga një zyrë në zyrën tjetër dhe procedurat ishin të gjata. Sidomos në kohën e pushimeve, kur shumë njerëz nga

diaspora kishin për të marrë dokumentet e nevojshme, gjendja vende vende bëhej kaotike. Me ambientet e rregulluar më mirë, me softuerin modern dhe me personel të shkolluar, shërbimet për qytetarët në komunë do të mund të kryhen në mënyrë shumë më efikase. Pastaj, çmimet e prera për shërbimet e caktuara sigurojnë transparencë.

HELVETAS Swiss Inetrcooperation deri më tash ka pajisur pesë komuna të Kosovës lindore me këso “One stop shops”, dhe, ku është treguar e nevojshme, ka bërë edhe trajnime për të punësuarit.



Një kryetar komune pa parti

Rufki Suma, më 3 nëntor është rizgjedhur kryetar i Komunës së Hanit të Elezit dhe këtë e ka arritur edhe pse ka qenë i vetmi kryetra komune në Kosovë që nuk i takon asnjë partie dhe që praktikisht nuk ka zhvilluar fare fushatë zgjedhore. Në muret e Hanit të Elezit nuk gjen pllakate të ngjitura që tregojnë portretin e tij, siç është e zakonshme për kandidatët tjerë në komunat e tyre.

Ndërsa lapsat e kuq kimikë me emrin e kryetarit, për të cilët ai ka përdorur paratë e dhëna për fushatë nga qeveria, i ka shpërndarë vetëm pas zgjedhjes së tij të suksesshme. Ku qëndron fshehtësia e suksesit të tij. Te puna e rëndë! Në ora gjashtë, nganjëherë edhe më herët, ai është në zyrë, i shikon dosjet dhe në orën tetë kur vijnë bashkëpunëtorët, ai ua ndan atyre punët. Në mbrëmje është i fundit që lëshon zyrën, shpesh pas orës 22 dhe kur shkon në shtëpi, fëmijët e tij të shumtën tashmë kanë fjetur. Për të dhe për familjen e tij ky funksion nuk është bekim, thotë ai në mënyrë lakonike.

Por, detyrat e komunës në aspektin infrastrukturual janë enorme. Mungon gjithçka, duke filluar nga rrjeti i ujësjellësit që funksionon keq, deri te rrjeti i pamjaftueshëm i rrugëve dhe te shërbimi i stërngarkuar i heqjes së mbeturinave. Ky i fundit realizohet me një kamion të vetëm, i cili i bart mbeturinat deri në deponinë e Gjilanit, qytetit që është rreth 50 kilometra larg. Më tutje vijnë në radhë shumë familje pa të ardhura, lidhur me kërkesat e të cilëve për mbështetje duhet të vendosë vetë kryetari i komunës, pasi që në Kosovë nuk ka sistem të sigurisë sociale sikur në Zvicër.

Një rreze shprese përbëjnë këtu shërbimet në zyrën e komunës, të cilat edhe në vitin e kaluar funksiononin më mirë se në komunat tjera. “Ne në dy vitet e kaluara, sipas statistikave të bëra nga qeveria, kemi qenë të dytët në mesin e komunave, sa i përket cilësisë së këtyre shërbimeve”, konstaton kryebashkiaku Suma. “Me zyrën e re ne do të jemi edhe më eficientë dhe shpresojmë se vitin e ardhshëm do të jemi në vendin e parë”. Strategji e suksesit të tij duket të jetë fakti se ai është shembull për punonjësit tjerë, se i i motivon dhe u tërheq vërejtjen.

Hani i Elezit është në fund të Grykës së Kaçanikut, në mes të dy vargmaleve dhe është vendi kufitar me Maqedoninë. Fshati me formë të gjatë buzë rrugës është qendra e fabrikës dikur shtetërore të cementit, Sharrcem, e cila pas luftës përgjatë dhjetë viteve është udhëhequr nga firma zvicerane Holcim përmes një marrëveshjeje leasing-u. Kurr Sharrcem, punëdhënësi më i madh i komunës me rreth 10 mijë banorë, në vitin 2010 u privatizua, atë e bleu firma greke Titan Group.

Prodhimi i cementit për dekada të tëra kishte ndotur ajrin dhe kishte mbuluar fshatin me pluhur ngjyrë hiri. Qëkur oxhaqet janë pajisur me filtra, ajri është bërë dukshëm më i pastër, rrëfen Refki Suma, duke na treguar një fotografi të vjetër të fshatit, ku duket një re e gjatë tymi e cila, duke dalë nga oxhaku, e nxin qiellin.

Ambiente të këndshme shkollore në Kaçanik

Ne vozisim mbrapa në drejtim të Prishtinës dhe ndalojmë në komunën fqinje, Kaçanik, ku HELVETAS Swiss Intercooperation ka ndihmuar në meremetimin e një shkolle fillore.

Komunat paraqesin projekte që kushtojnë më së shumti 10 mijë euro ndërsa HSI financon ato në shkallën 70-90 për qind. Në këtë mënyrë mund të sigurohen banka të reja, të pajisen bibliotekat shkollore, të rregullohen trotuaret për të bërë më të sigurt rrugën deri te shkolla, të mbulohen vendndalesat e autobusëve ose të rregullohen sheshe sportive etj.

Në shkollën “Emin Duraku” ndjekin mësimet 1800 nxënës në dy ndërrime, mesatarisht nga 30 për çdo klasë. Gjithkrah vlon nga nxënësit që vijnë dhe ata që shkojnë kur ne afrohem në oborrin e shkollës. Drejtori na çon përmes korridoreve të gjatë, të ngjyrosur rishtas me ngjyrë të kaltër të ndritshme. Me këtë rast na tregon klasat e shkollës p ashtu të ngjyrosura, me dyer të mira dhe me dysheme linoleumi.

Fëmijët thonë “Mirëdita” sapo mësuesja të hapë derën dhe shikojnë me kërshtëri mysafirët e ardhur. Janë edhe ca gjëra tjera për të cilat do të kishte nevojë kjo shkollë, para se gjithash një sallë e fizkulturës. E vjetra është dashur t`i bëjë vend tri klasave të reja të mësimi. Kështu, në vend të orëve të fizkulturës, gjatë dimrit ligjërohet teori sporti në klasë. Për shembull, nxënësit mësojnë rregullat e lojës së futbollit. Gjatë verës ata e kanë në dispozicion oborrin e madh të shkollës.

Nga godina e shkollës deri në komunë, ku kryetari i komunës Besim Ilazi po ashtu është rizgjedhur në raundin e parë, a konfirmon se buxheti i komunës, të cilin qeveria e ndan përmes një çelësi të caktuar, nuk mjafton as për afërsisht për t`i plotësuar të gjitha nevojat që ka komuna. Ai është mirënjohës për përkrahjen nga Zvicra dhe shpreson për një bashkëpunim të mëtejshëm të mirë. Një e treta e buxhetit ose më shumë duhet të plotësohet nga ndihmat e donatorëve të jashtëm. Shkollat, rrugët, sistemi i kanalizimit dhe ujësjellësi, ngado paraqitet nevoja për rinovim.

Elisabeth Kaestli